



Pranuar / Dorezuar Priljezhen / Predatohet Received / Delivered	10.02	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Org. / Unit	No. Prot. No. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHCK	596/2021		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.441/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari–kryetare, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.441/2020 të datës 29.12.2020 e parashtruar përmes postes së Kosovës nga ankuesja [redacted] me adresë rruga “Fatmir Ibishi”, Nr.3/35 në Gjilan, kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.441/2020, e datës 29.12.2020, e parashtruar nga ankuesja [redacted]

II.MBETET në fuqi Vendimi me numër protokoli 111807/2 i datës 09.12.2020 i Komisionit të Pranimit i Komunës së Gjilanit, dhe Njoftimi me nr. 016-111552 i datës 02.12.2020 për përzgjedhjen e kandidatës së suksesshme për pozitën “Zyrtare për Gjendje Civile 1”, në Sektorin e Gjendjes Civile në Komunën e Gjilanit.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] ka aplikuar në pozitën: “Zyrtare për gjendje civile 1”, të shpallur me datë 30.06.2020 nga Komuna e Gjilanit me nr.Ref.RN00006012, në bazë të autorizimit të datës 26.06.2020 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shpalljen e konkursit të jashtëm, nga data 30.06.2020 deri me 14.07.2020.

Me datë 02.12.2020 Komuna e Gjilanit ka publikuar njoftimin me nr. 016-111552 për përzgjedhjen e kandidatës së suksesshme për pozitën “Zyrtare për Gjendje Civile 1”, në Sektorin e gjendjes civile në Komunën e Gjilanit.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 02.12.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit në Komunë të Gjilanit, i cili me datës 09.12.2020 ka nxjerrë Vendimin me numër protokoli 111807/2 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses duke lënë në fuqi listën përfundimtare të datës 02.12.2020 të rezultateve të shpallura .

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin e datës 09.12.2020 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Gjilanit, me datë 29.12.2020 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës së Kosovës me datë 24.12.2020 me numër të postës R1305715.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.01.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit. Këshilli më datë 26.01.2021 ka pranuar dokumentacionin e bashkangjitur nga Komuna e Gjilanit, lidhur me ankesën e ankueses prej 1/108 faqe.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën Anr.441/2020 me numër protokolli 3334/2020 të datës 29.12.2020 e parashtruar nga ankuesi [redacted] në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; zarf me numër postare R1305715; Vendimi i datës 09.12.2020 nr. 1118807/2 i Komisionit të pranimit; Kërkesë e datës 03.12.2020; Ankesa e datës 03.12.2020 i Komisionit të pranimit; Përgjigje në ankesë e datës 26.01.2021; Akte emërimit i datës 22.07.2011; Akte emërimit i datës 07.05.2014; Akte emërimit i datës 22.07.2011; Akte emërimit i datës 01.02.2013; Raporti i vlerësimit nga testi i mbajtur me shkrim i datës 02.11.2020; Njoftimi i datës 02.11.2020 i testit me shkrim; Formulari për CV; Raporti për përfundimin e konkurrimit, hartimin e listës me vlerësimet përfundimtare dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare; Listë e datës 02.12.2020 përfundimtare me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve; Njoftim i datës 02.12.2020 përfundimtar; E-mail i datës 02.12.2020; Formulari i datës 10.07.2020; Kërkesa për punësim i datës 09.07.2020; Diplomë e datës 28.09.2018; Vërtetim i datës 08.02.2019; Certifikate e datës 31.05.2018; certifikatë e datës 27.01.2018; certifikatë e datës mars 2015; Marrëveshje për angazhim në masën aktive të tregut të punës praktike në punës e datës 06.08.2019; Formular të intervistës me gojë; Pëlqim i datës 07.12.2020; Akt emërim i datës 30.12.2020; Letër referencë e datës 21.11.2016; Konfirmimi i buxhetit i datës 26.06.2020; Autorizimi i datës 26.06.2020; shpallja e Konkursit i datës 30.06.2020; Vendimi i datës 10.07.2020 për themelimin e komisionit përzgjedhës; Kërkesë për punësim Arlinda Tahiri; Diplomë e datës 11.10.2016; Marrëveshje për punë praktike e datës 01.09.2015; Referencë e datës 25.01.2016; Vërtetim i datës 25.01.2016; Kontratë konsulentë Nr.03-02/RB/2014; Vërtetim i datës 08.09.2009; Referencë e datës 08.09.2009; Referencë; Referencë nga Gjykata Themelore Gjilan; Certifikatë e datës 30.09.2013; certifikatë e datës 13.04.2012; certifikatë e datës 21.10.2013; certifikatë e datës 04.01.2012; certifikatë e datës 14.12.2012; Certifikatë e datës 06.10.2000; Certifikatë e datës 14.06.2012; certifikatë e datës 20.01.2015; Regjistrimi i aplikacioneve të pranuar Form: MAP - SHCK; Raport i listës së shkurtër i datës 16.07.2020; Njoftim i datës 28.09.2020 për kandidatët që kanë konkurruar në konkursin e datës 30.06.2020; Njoftimi i datës 27.10.2020 për listën e ngushte; zarfe e datës 22.01.2021 me numër R1379143; Kërkesë për prova shtesë e datës 28.01.2021; Përgjigje e datës 29.01.2021 sipas kërkesës, kopje e testit me shkrim i plotësuar nga Diellza Shehu, kopje e testi me shkrim i plotësuar nga [redacted].

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e pa bazuara, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që të vlerësohen provat materiale dhe jo materiale nga shkresat e lëndës si dhe pas vlerësimit të dosjeve të aplikantëve të merr vendim për anulimin e pjesërisht të konkursit për pozitën "Zyrtar për gjendje civil 1", nr.ref.RN00006012, si dhe të detyrohet komuna e Gjilanit që të vendos që paneli i rekrutimit të përbëhet nga persona të tjerë të cilët nuk kanë konflikt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me kandidatët që aplikojnë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret themelore të konkursit për pozitë "Zyrtar për Gjendje Civil 1", në Komunën e Gjilanit, kanë qenë: **Diplome Universitare**

Fakulteti Juridike apo Administratë Publike, pa përvojë ose Shkolle e Larte dhe se paku dy(2) vite, përvojë pune profesionale, pas diplomimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës të ankueses dhe organit të punësimit gjegjësisht Komunës së Gjilanit, ka konstatuar se fillimisht konkursi është publikuar me datë 30.06.2020, pasi ka pranuar autorizimin e datës 26.06.2020 nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe me datë 10.07.2020 Kryetari i Komunës së Gjilanit, ka themeluar Komisionin e Pranimit, në pajtim me nenin 17 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimi Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit pas mbylljes së konkursit të shpallur me datën 30.06.2020, ka zbatuar dispozitat transitorë duke vazhduar procedurën e rekrutimit në bazë të nenit 84 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, e gjithë procedura e rekrutimit për këtë pozitë është zhvilluar në pajtim me dispozitat e neni 21.22 dhe 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas administrimit të provave ka konstatuar se testi me shkrim për pozitën **"Zyrtar për Gjendje Civil I"**, është përpiluar në pajtim me nenin 21 paragrafin 5 dhe paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: **"Komisioni i Pranimit mund të zgjedh një grup pyetjesh, nga baza e të dhënave për testimin me shkrim, për testimin e fushës së njohurive, të aftësive e të cilave të kërkuara për grupin përkatës. Pyetjet hartohen sipas modelit, Zgjedhja e shumëfishtë, me një përgjigje të saktë"**, paragrafi 6 **"Numri i pyetjeve të testimit me shkrim mund të jetë jo më pak se pesëdhjetë (50) pyetje dhe jo më shumë se shtatëdhjetë (70) pyetje"**, që në rastin konkret duke u bazuar në provat e lëndës është vërtetuar se Komisioni i Pranimit, testin me shkrim e ka përgaditur duke u bazuar në tërësi sipas dispozitave ligjore të lartë cekura dhe se pretendimet e ankueses lidhur me dyshimin se tetsin me shkrim e ka pasur kandidatja e përzgjedhur, kjo nuk qëndron nga se ankuesja nuk ka prezentuar asnjë dëshmi apo ndonjë provë relevante që lidhen me këtë pretendim ankimor, sepse komisioni mbanë përgjegjesi ligjore për ruajtjen e informatave të testit me shkrim, në pajtim me nenin 21 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja [redacted] e cila ka aplikuar në pozitën **"Zyrtar për Gjendje Civil I"**, i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe me datën 27.10.2020 është njoftuar me njoftimin me nr.02-016-99233, se testi me shkrim do të mbahet me datën 29.10.2020, dhe ka marrë pjesë duke u vlerësuar me 49 pikë, ankuesja me datën 17.11.2020 ka marrë pjesë në intervistën me gojë e cila është vlerësuar me 4.7 pikë, po ashtu është vlerësuar për CV me 11 pikë, ku gjithsejtë ka arritur 65.2 pikë në total. Lidhur me këtë Kolegji ka konstatuar se Komisioni i Pranimit ka bërë llogaritjen e rezultatit përfundimtar, në pajtim me nenin 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Kurse pretendimet e tjetër të ankueses lidhur me konfliktin e interesit të pretenduar në mes të aplikantëve dhe komisionit të pranimit, nuk janë vërtetuar me asnjë dëshmi nga ana e saj dhe nuk janë evidente për tu shqyrtuar nga Kolegji i Këshillit.

Me datë 02.12.2020 Komuna e Gjilanit, ka nxjerrë njoftimin për kandidaten e suksesshëm, në pozitën **"Zyrtar për Gjendje Civil I"**, kandidatja me më shumë pikë gjatë testit me shkrim dhe me gojë, është përzgjedhur znj. [redacted] me gjithsejtë 89.1 pikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni i Pranimit me rastin e përzgjedhjes së kandidatës znj. [redacted] për pozitën **"Zyrtar për Gjendje Civil I"**, në

Komunën e Gjilanit, si kandidatja e cila ka grumbulluar më së shumti pikë,ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se : neni 24 **“Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit”**. Kandidatja e përzgjedhur _____ posedon: Diplomën me numër Nr.98 të datës 28.08.2018, të lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan dhe mori titullin Baçellor në Juridik, LLB,e cila ka qenë e angazhuar në Komunën e Gjilanit me marrëveshje për shërbime të veçanta (me masë aktive të tregut të punës-praktik në punë),nga data 07.08.2019 deri me datë 31.01.2020.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave,në bazë të të gjitha provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni i Pranimit,procedurën e rekrutimit për pozitën **“Zyrtar për Gjendje Civil 1”** në Komunën e Gjilanit e ka zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, bazuar në nenin 83 paragrafi 9 dhe nenin 17, 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative.Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni i Pranimit ka vepruar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil të Kosovës nga se ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit,vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.441/2020

Zyle Millaku GOJNOVCI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit:
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Gjilanit,
- Arkivit të KPMSHCK-së.